



ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 73, datë 22.04.2020

MBI

**MIRATIMIN E KONTRATËS TIP PËR SHITBLERJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE
NDËRMJET SHOQËRISË SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, AKSIONET
E SË CILËS KONTROLLOHEN PLOTËSISHT OSE PJESËRISHT NGA SHTETI DHE
FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL PËR FURNIZIMIN E KLIENTËVE
FUNDORË.**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 20 gërma h, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, VKM Nr.244, datë 30.03.2016 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, i ndryshuar me VKM nr. 883 datë 27.12.2019; nenit 26 të “Rregullores të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.04.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e hartuar nga Drejtoritë e ERE-s, në lidhje me miratimin e Kontratës tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe furnizuesit të shërbimit universal për furnizimin e klientëve fundorë,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE me vendimin nr. 8, datë 16.01.2020, vendosi për fillimin e procedurës për miratimin e “Kontratës tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe furnizuesi i shërbimit universal për furnizimin e klientëve fundorë”.
- Në vijim, drafti për të cilën ka filluar procedura i është dërguar palëve të interesit për marrjen e qëndrimit të tyre dhe opinioneve me shkresën e ERE nr.112 prot datë 21.01.2020.

- Në vijim, me shkresën e ERE nr. 108 prot, datë 21.02.2020, u dergua njoftimi për zhvillimin e një seance dëgjimore ku u ftuan të marrin pjesë përfaqësues të FSHU sh.a., KESH sh.a., Autoritetit të Konkurrencës dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.
- Në datë 05.02.2020, në ERE u organizua seanca dëgjimore në të cilën morën pjesë të gjitha palët e interesit të ftuara për të diskutuar.
- Gjatë kësaj seance dëgjimore, KESH sh.a. shprehu qëndrimin e saj në lidhje me disa dispozita të draftit për të cilin ka filluar procedura.
 - KESH sh.a. kërkoi që në zbatim të ndryshimeve që prodhoi VKM nr. 883 datë 27.12.2019, në VKM nr. 244/2016, duke ia lënë në diskrecion të asamblesë së përgjithëshme të shoqërisë së prodhimit përcaktimin e elementëve të kontratës si sasi energjie/çmimi i shitjes për nevoja të FSHU sh.a./ çmimi i kompensimit mes palëve, të mos parashikohet detyrimi i Asamblesë së përgjithëshme të shoqërisë për përcaktimin e këtyre komponentëve si pjesë e programit të zhvillimit ekonomik të shoqërisë së prodhimit.
 - Ky konstatim u gjet i drejtë dhe u pranua si i tillë edhe nga palët pjesëmarrëse në seancë.
 - KESH sh.a. kërkoi që parashikimi i përfshirë në Draft kontratën TIP, i cili kërkonte që KESH sh.a. për përcaktimin e sasisë së energjisë që do të ofrojë për sigurimin e shërbimit publik të bazohet në nivelin historik mesatar vjetor të dhjetë viteve të fundit, sipas informacionit të dhënë nga ERE dhe regjimit racional të shfrytëzimit të kapaciteteve gjeneruese, të mos jetë pjesë e parashikimeve të kësaj kontrate.
 - Sa më sipër, nuk gjeti dakortësinë e përfaqësuesve të FSHU sh.a. të cilët kërkuan që ERE të ketë rol mbikqyrës mbi termat e referencës së KESH sh.a. për përcaktimin e sasisë së energjisë të parashikuar për përmbushjen e shërbimit publik.
 - Në lidhje me sa propozuar nga KESH sh.a. si dhe sa argumentuar nga FSHU sh.a., konstatojmë se VKM nr. 883 datë 27.12.2019, e ka lënë në diskrecionin e Asamblesë së përgjithëshme të shoqërisë së prodhimit përcaktimin e sasisë së energjisë për sigurimin e shërbimit publik, por kjo nuk përjashton ERE-n nga roli mbikqyrës e monitorues në lidhje me përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik nga palët duke patur interes parësor mbrojtjen e interesave të klientëve fundorë të energjisë elektrike.
 - MIE në cilësinë e Asamblesë së Përgjithëshme të Shoqërisë së prodhimit KESH sha, referuar parashikimeve të VKM-s Nr. 883, date 27.12.2019, "Draft-kontratës TIP për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike KESH sh.a, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe furnizuesit të shërbimit universal FSHU sh.a. për

furnizimin e klienteve fundorë" dhe propozimeve të dërguara nga KESH Sh.a, me shkresën Nr. 308/1 Prot., datë 13.02.2020, bën me dije se: *“Për përcaktimin e sasisë dhe cmimit për njësi të energjisë elektrike, për qëllime të plotësimit të kërkesës së plotë të furnizuesit të shërbimit universal, Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë së prodhimit të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, do të bazohet në nivelin historik mesatar vjetor të dhjetë viteve të fundit, sipas informacionit të dhënë nga ERE dhe regjimit racional të shfrytëzimit të kapaciteteve gjeneruese”.*

- KESH sh.a. parashtroi se, kushtet e parashikuara në nenin 13, pika 2 të draft kontratës TIP, se "Shitësi do t'i dorëzojë Blerësit nje faturë sipas formatit dhe standardeve që parashikon legjislacioni në fuqi, e cila paraqet sasi të totale të energjisë elektrike të livruar nga shitësi dhe konsumuar nga blerësi për Muajin kalendarik paraardhës" duhet të adresohen në frymën e rregullave të tregut dhe marrëdhëniet e palëve në tregun e energjisë të realizohen bazuar në sasi të nominuara të energjisë elektrike.
- Autoriteti i Konkurrencës dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, pjesëmarrëse në seancën dëgjimore të organizuar nga ERE, shprehën qëndrimin e tyre se bien dakort me sa propozuar dhe plotësuar nga palët në këtë seancë.
- Në kontratën e përgatitur janë reflektuar edhe ndryshimet e fundit të VKM 244/2016 (VKM 883, datë 27.12.2019, ku parashikohet se :*“Ndërmjet furnizuesit të shërbimit universal dhe shoqërisë së prodhimit të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik nënshkruhet kontrata TIP, e miratuar nga Enti Rregullator i Energjisë, e cila negociohet çdo vit, në lidhje me sasinë e energjisë së siguar dhe çmimin për njësi, përpara fillimit të çdo viti kalendarik të ushtrimit të aktivitetit”*
- Në kuptim të sa më sipër, janë palët që kanë detyrimin për të negociuar dhe nënshkruar me njëra tjetrën kontratë të rinovuar për çdo vit ushtrimor, në të cilën të reflektohen dispozitat apo ndryshimet e dakortësuara që lidhen ekskluzivisht me elementet çmim dhe sasi.
- Draft kontrata propozohet e strukturuar në 21 nene dhe 2 shtojca të cilat adresojnë të drejtat dhe detyrimet e palëve, modalitetet e livrimit të energjisë elektrike dhe matjes, mënyrën e kushtet e kompensimit për mosperformancë të njëjës nga palët, mënyrat e faturimit dhe kryerjes së pagesave etj.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

VENDOSI

1. Të miratojë “Kontratën tip për shtiblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht

nga shteti dhe furnizuesi i shërbimit universal për furnizimin e klientëve fundorë.(Bashkëlidhur)

2. Drejtoria e Çështjeve Ligjore të njoftojë të interesuarit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI

Nr. _____ prot, datë ____ / ____ / _____

Nr. _____ prot, datë ____ / ____ / _____

KONTRATË TIP PËR SHITBLERJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE NDËRMJET SHOQËRISË SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË NGARKUAR ME DETYRIMIN E SHËRBIMIT PUBLIK , AKSIONET E SË CILËS KONTROLLOHEN PLOTËSISHT OSE PJESËRISHT NGA SHTETI DHE FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL(FSHU) SH.A.,PËR FURNIZIMIN E KLIENTËVE FUNDORË PËR PERIU DHËN KOHORE

dd/mm/vvvv - dd/mm/vvvv

E lidhur sot më datë ____ . ____ . _____ ndërmjet:

Shoqërisë së prodhimit të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik aksionet e së cilit kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti _____, e përfaqësuar nga _____, Administrator i Shoqërisë që më poshtë do të quhet “Shitësi”,

Dhe

Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) SH.A., me objekt aktiviteti në: furnizimin me energji elektrike të klienteve fundorë që veprojnë në treg të rregulluar të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi, ofrimin dhe sigurimin e cilësisë tregtare të shërbimit, si dhe çdo aktivitet tjetër fitimprures me interes për shoqërinë, _____, përfaqësuar nga _____, Administratori i Shoqërisë _____, që më poshtë quhet “Blerësi”,

(“Palët” ose “Pala” në këtë kontratë do të referohen në cilësinë e Shitësit, shoqërisë së prodhimit të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik aksionet e së cilit kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe në cilësinë e Blerësit, Furnizuesit të ngarkuar me detyrimin e Shërbimit Universal të Furnizimit (FSHU) SH.A.,

Baza ligjore: neni 20 germa h, e Ligjit Nr.43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, Vendimi Nr. 244, datë 30.03.2016, i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike” i ndryshuar, Rregullat e Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike”, Vendimi i Bordit të ERE “Për përcaktimin e të licencuarit të ngarkuar me detyrimin e shërbimit universal për tregun e energjisë elektrike dhe përcaktimin e kushteve për ushtrimin e detyrimit të shërbimit universal”, Vendimi i Ministrit përgjegjës për Energjinë (në cilësinë e përfaqësuesit të shtetit si pronar i aksioneve të subjektit prodhues i ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik) Asamblenë e Përgjithshme të Shoqërisë

Në kushtet kur:

- Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) SH.A., në aktivitetin e licencuar të furnizuesit është ngarkuar me detyrimin e Shërbimit Universal të Furnizimit me energji elektrike për kategorinë e klientëve fundorë që përfitojnë nga Shërbimi Universal i Furnizimit me energji elektrike, në përputhje me parashikimet e pikës 1, të nenit 109, të Ligjit nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, Vendimit nr.449, datë 15.06.2016, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kushteve dhe procedurave për përcaktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike dhe vendimit të Bordit të ERE “Për përcaktimin e të licencuarit të ngarkuar me detyrimin e shërbimit universal për tregun e energjisë elektrike dhe përcaktimin e kushteve për ushtrimin e detyrimit të shërbimit universal”,
- Furnizuesit të Shërbimit Universal i është vendosur detyrimi i shërbimit publik për të blerë sasinë e nevojshme të energjisë elektrike, të prodhuar nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti;
- Sasia e energjisë elektrike, për qëllime të përmbushjes së detyrimit për shërbim publik përkundrejt Furnizuesit të Shërbimit Universal, miratohet nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë së prodhimit të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti
- Ministri përgjegjës për energjinë (në cilësinë e përfaqësuesit të shtetit si pronar i aksioneve të shoqërisë së prodhimit të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik aksionet e së cilit kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti në Asamblenë e Përgjithshme të Shoqërisë) me vendimin -----
----- datë ----- ka miratuar sasinë dhe çmimin e shitjes së energjisë elektrike për qëllime të furnizimit të Furnizuesit të Shërbimit Universal në kuadër të detyrimit për shërbim publik si edhe sasinë dhe çmimin për qëllime të kompensimit financiar për mosperformancë nga ana e shoqërisë së prodhimit të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik aksionet e së cilit kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti..
- Sasia e energjisë elektrike dhe çmimi i i miratuar pasqyrohen në kontratën e lidhur nga palët, dhe sipas pikës 2 të nenit 5 të, VKM Nr. 244, datë 30.03.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”te ndryshuar”

Palët bien dakort lidhur me përmbajtjen e kontratës së shit-blerjes së energjisë elektrike në kuadër të përmbushjes së detyrimit për shërbim publik si më poshtëvijon:

NENI 1 QËLLIMI I KONTRATËS

Kjo Kontratë(së bashku me Shtojcat e saj) rregullon të gjithë marrëdhënien e shitjes dhe blerjes së energjisë elektrike ndërmjet Palëve përfshirë këtu dhe jo vetëm programimin dhe nominimin (livrimin dhe pranimin) e energjisë elektrike për periudhën kohore 1 Janar-31 Dhjetor.

NENI 2

SASIA E KONTRAKTUAR DHE ÇMIMI I SHITJES

1. Sasia e programuar (kontraktuar për vitin) e prodhimit të energjisë elektrike që Shitësi është i detyruar të furnizojë (ose kompensojë financiarisht) Blerësin, për vitin -----, është ajo e përcaktuar në Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Shitësit ;. nr.-----prot/ datë ___/___/____” dhe sipas këtij vendimi është _____ MWh e cila i furnizohet blerësit në përputhje me parashikimet e nenit 4 dhe 5 të kësaj kontrate.
2. Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për vitin ____ është ai i miratuar me Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Shitësit;. nr.-----prot/ datë ___/___/____” dhe sipas këtij vendimi është ___ leke/kWh.
3. Shitësi në varësi të përmirësimit të kushteve hidrike, të gjithë sasinë e prodhimit të energjisë elektrike mbi atë të parashikuar në pikën 1, por në çdo rast jo më shumë se sasia e nevojshme për furnizimin e klientëve fundorë që përfitojnë nga shërbimi universal i furnizimit, është i detyruar t’ja ofrojë(propozojë) fillimisht Blerësit me çmimin e parashikuar në pikën 2.
4. Blerësi, brenda afatit të vendosur nga shitësi, është i detyruar të konfirmojë mbi mundësinë që ka për të pranuar energjinë e ofruar nga Shitësi sipas parashikimeve në pikën 2. Në rast se Blerësi, brenda afatit të njoftuar nga Shitësi, nuk konfirmon mbi mundësinë që ka për të pranuar energjinë e ofruar nga Shitësi sipas pikës 2, propozimi quhet i refuzuar.

NENI 3

PËRKUFIZIMET

1. **Referencat në Kohë:** Referencat e kohës do të jenë sipas Kohës Qendrore Evropiane (CET).
2. **Përputhja me Aktet nënligjore dhe Rregullat e Tregut:** Kjo Kontratë hartohet në përputhje me parashikimet e akteve ligjore dhe nënligjore në sektorin e energjisë elektrike. Në rast se ndonjë parashikim në këtë Kontratë bie në kundërshtim me ndonjë parashikim në aktet ligjore dhe rregullatore në fuqi, atëherë, ky parashikim në kontratë konsiderohet i pavlefshëm/pazbatueshëm dhe marrëdhënia rregullohet sipas parashikimeve të aktit në fuqi.
3. **Vlera e kompesimit:** Vlera që rezulton për sasinë e energjisë së paplotësuar nga shitësi me çmimin e përcaktuar sipas parashikimeve të nenit 5 të VKM 244/2016, i ndryshuar
4. **Çmim i kontratës:** Çmimi i përcaktuar sipas parashikimeve të nenit 5 të VKM 244/2016, i ndryshuar
Fatura e kompesimit: Fatura që do të nënshkruhet nga shitësi dhe blerësi në lidhje me sasinë e energjisë të paplotësuar nga ana e shitësit në fund të muajit janar të çdo viti për vitin paraardhës.
5. **"Dita e Punës"** do të thotë një ditë (përveç së shtunës dhe së dielës) në të cilën bankat komerciale janë të hapura për biznes të përgjithshëm në vendet ku secila Palë ka zyrën e saj të regjistruar;
6. **“Përgjegjësia për Balancimin”** çdo pjesëmarrës i tregut të energjisë elektrike është përgjegjës për balancimin e energjisë elektrike
7. **"Koha Qendrore Evropiane"** ose **"CET"** do të thotë Koha Qendrore Evropiane dhe do të përfshijë Kohën Dimërore Qendrore Evropiane dhe Kohën Verore Qendrore Evropiane sipas zbatimit;
8. **"Konfirmimi"** ka kuptimin e specifikuar në Nenin 5 dhe 6;
9. **"Kapaciteti i Kontratës "** lidhur me një Kontratë Individuale do të thotë, kapaciteti i vendosur mes Palëve, i shprehur në MW;

10. "**Çmimi i Kontratës**" lidhur me një Kontratë Individuale do të thotë, çmimi i vendosur nga Asambleja e shitësit sipas VKM 244/2016 të ndryshuar;
11. "**Sasia e Kontratës**" lidhur me një Kontratë Individuale do të thotë, sasia e vendosur mes Palëve, sipas nenit 2 të kësaj kontrate, e shprehur në MWh
12. "**Dëmet**" ka kuptimin e specifikuar në pikën 13. (**Kufizimi i Përgjegjësisë Financiare**)
13. "**Pala që nuk përmbush detyrimet**" ka kuptimin e specifikuar në pikën 10 (**Pezullimi i Livrimit**);
14. "**Filial**" lidhur me një Palë do të thotë një Njësi e Kontrolluar, direkt ose indirekt, nga ajo Palë, çdo Njësi që Kontrollon direkt ose indirekt atë Palë ose çdo Njësi direkt ose indirekt nën Kontrollin e përbashkët të një Pale
15. "**Pika e Livrimit**" lidhur me një Kontratë Individuale do të thotë pika e livrimit e vendosur mes Palëve;
16. "**Programi i Livrimit**" lidhur me një Kontratë Individuale do të thotë programi i livrimit i vendosur mes Palëve për ditën në avance sipas rregullave përkatëse;
17. "**Data e Pagesës**" ka kuptimin e specifikuar në pikën 14.2 (**Pagesa**)
18. "**Data e Hyrjes në Fuqi**" ka kuptimin e vendosur në faqen e parë të kësaj Kontrate;
19. "**Programi**" ka kuptimin e specifikuar në nenin 6, pika 3 dhe 7.2 (**Përkufizimi i Programit**) dhe "**IProgramuar**" dhe "**Programimi**" do të interpretohen sipas kësaj;
20. "**Taksë**" do të thotë çdo taksë e tanishme ose e ardhshme, kuotë, taksëimporti, detyrim, pagesë, vlerësim ose tarifë e çdo natyre (përfshirë interesin, gjobat dhe shtesat e tyre) që vendoset nga çdo qeveri ose autoritet tjetër taksash (përpërfitimin ose jo të tij) lidhur me çdo pagesë sipas Kontratës përveç taksës së vulës, regjistrimit, dokumentacionit ose ndonjë taksë të ngjashme;
21. Çdo term tjetër I përdorur në këtë kontratë do të lexohet në kuptimin e dhënë në legjislacionin në fuqi.

NENI 4

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E BLERËSIT

1. Blerësi do t'i paraqesë shitësit programet mujore/javore/ditës në avancë me bazë orare/ngarkesës për klientët fundorë në përputhje me parashikimet e akteve rregullatore në sektorin e energjisë elektrike dhe sipas formatit të parashikuar në aneksin e kësaj kontrate.
Blerësi jo më vonë se 7 ditë kalendrike përpara fillimit të muajit të furnizimit do t'i dërgojë Shitësit gjithë të dhënat që lidhen me parashikimin e ngarkesës për muajin pasardhës me bazë javore/ditore të ngarkesës.
2. Blerësi jo më vonë se dita e mërkure e çdo jave do ti dërgojë Shitësit të dhënat që lidhen me ngarkesën e klientëve fundorë për sasinë e javës në avancë me bazë ditore/orare.
3. Blerësi duke marrë në konsideratë programet e dërguara për muajin/javën në avancë nga Shitësi, do ti dërgojë shitësit brenda orës 11:00 programin e ditës në avancë me bazë orare të ngarkesës.

NENI 5

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E SHITËSIT

1. Shitësi do të furnizojë dhe blerësi do të pranojë sasinë e energjisë elektrike të konfirmuar nga shitësi për blerësin sipas parashikimeve në pikën 2, 3 dhe 4. Në rast se nuk do të ketë dakortësi midis palëve

- per sa parashikuar në nenet 4 dhe 5, atëherë për palët do të jetë i detyrueshem nominimi i pranuar nga Platforma e OST për nominimet.
2. Shitësi, jo më vonë se 5 ditë kalendrike përpara fillimit të muajit në të cilin do të bëhet furnizimi, do të konfirmojë për blerësin programet mujore/javore/ditore me bazë orare të prodhimit si dhe kapacitetin maksimal dhe minimal të furnizimit tëdetyrueshëm për blerësin për qëllime tëpërmbushjes nga shitësi tëdetyrimit për shërbim publik të ofrimit të shërbimeve tëbalancimit për OST
 3. Shitësi në vijim të konfirmimit sipas pikës 2, jo më vonë se dita e enjte e çdo jave, do të konfirmojë për Blerësin programet javore/ditore me bazë orare të prodhimit.
 4. Shitësi, duke marrë në konsideratë konfirmimet e dërguara për muajin/javën në avancë do ti dërgojë blerësit brenda orës 12:00 konfirmimin për programin e furnizimit për qëllime të nominimit në Platformë e OST për nominimet për ditën në avancë (me bazë orare të prodhimit siç kërkohet nga Platforma e OST për nominimet.) dhe do të jetë përgjegjës për përmbushjen e këtij detyrimi për Ditën në Avancë.

NENI 6

DETYRIMET KRYESORE PËR FURNIZIMIN ME ENERGJI ELEKTRIKE

1. **Përgjegjësia për balancimin e energjisë:** Shitësi dhe blerësi janë subjekte të rregullave në fuqi për balancimint dhe për rrjedhojë përgjegjës për balancimin e energjisë elektrike perkundrejt OST (deri sa nuk kanë njëmarrëveshje që rregullon përgjegjësinëe balancimit me tëtretët).
2. **Nominimi (Livrimi dhe Pranimi):** Shitësi dhe blerësi do të nominojnë nëPlatformën e OST për nominimet. Bazuar në konfirmimet e bëra paraprakisht, çka përbën konfirmimin për livrimin (Shitësi) dhe pranimin (Blerësi) e energjise elektrike objekt i kësaj kontrate. Sasia sipas programit tënominuar për ditën në avancë ose intraday (në rastet e rishikimit të programit të nominuar) ështësasia kontraktuale për të cilën Blerësi do të paguajë Shitësit me çmimin e përcaktuar në nenin 2 të Kontratës.
3. **"Program"** sipas zbatimit, do të thotë veprimet e nevojshme për një Palë për kryerjen e detyrimeve përkatëse të livrimit dhe pranimit, që përfshin programimin, njoftimin, kërkimin dhe konfirmimin me Palën tjetër, agjentët dhe përfaqësuesit e tyre të autorizuar përkatës apo me OST, Sasinë e Kontratës, Kapacitetin e Kontratës, Pikën e Livrimit, Programin e furnizimit, Periudhën Totale të Furnizimit, dhe çdo kusht tjetër të Kontratës sipas gjithë rregullave të zbatueshme dhe praktikave e procedurave të tjera të zakonshme industriale.

NENI 7

LIVRIMI, MATJA, TRANSMETIMI DHE RISKU

1. **Rryma/Frekuenca/Tensionet:** Energjia Elektrike do të livrohet me rrymën, frekuencën dhe tensionin e zbatueshëm në Pikën përkatëse të Livrimit sipas standarteve të parashikuara në Kodet dhe Rregullat ne fuqi.
2. **Programet e Deklaruara:** Sasia e Energjisë Elektrike që do të programohet dhe konfirmohet nga Shitësi për Blerësin, do t'i furnizohet këtij të fundit mbi baza vjetore, mujore, javore, ditore dhe orare në përputhje me Rregullat e Tregut te Energjisë Elektrike si dhe Kodet e Rrjetit. Nominimi fizik/programi i livrimit për ditën e nesërme duhet paraqitur në përputhje me Rregullat e Tregut dhe Kodet ne fuqi.

3. **Dokumentacioni i Livrimeve dhe Marrjeve në Dorëzim:** Bazuar në një kërkesë të arsyeshme, Palët:
 - do t'i sigurojnë njëra-tjetrës dokumentacionin që posedojnë ose do të kontrollojë paraqitjen e Programeve, sasive, livrimeve dhe pranimit të energjisë elektrike për qëllimet e përcaktimit të shkakut të çdo devijimi mes afateve të Kontratës Individuale dhe marrjeve aktuale në dorëzim të energjisë elektrike (referuar nominimit në Platformën e OST për nominimet).
4. **Risqet e Shitësit dhe Blerësit:** Shitësi do të marrë përsipër gjithë risqet dhe do të përgjigjet për çdo kosto apo pagesë të vendosur ose shoqëruese të Programimit, transmetimit dhe livrimit të Sasisë së energjisë së parashikuar në Kontratë deri në Pikën e Livrimit. Blerësi do të marrë përsipër gjithë risqet dhe do të përgjigjet për çdo kosto ose pagesë të vendosur ose shoqëruese të Programimit, pranimit dhe transmetimit të Sasisë së Kontratës në dhe nga Pika e Livrimit.
5. **Pikat e Livrimit:** Shitësi do ta livrojë energjinë elektrike në kufijte e sistemit të transmetimit të OST, me kusht që të ekzistojnë matës në këto pika për të lejuar verifikimin e shumave dhe kohës së livrimeve.

NENI 8

MOS-PERFORMANCA PËR SHKAK TË FORCËS MADHORE

1. **Përkufizimi i Forcës Madhore:** Përveç se kur specifikohet ndryshe, "**Forcë Madhore**" për qëllimet e Kontratës do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të arsyeshëm të Palës që pretendon Forcën Madhore ("**Pala Pretenduese**"), siç përcaktohet në Ligjin nr.43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", i ndryshuar, që nuk mund ta shmangte ose ta kapërcente në mënyrë të arsyeshme dhe që bën të pamundur që Pala Pretenduese të kryejë detyrimet e livrimit ose pranimit, për shkaqet e mëposhtme, por pa u kufizuar me to:
 - a) defekti në komunikim ose i sistemeve kompjuterikë të OST-së përkatëse që e pengon Palën Pretenduese të kryejë detyrimet e livrimit ose pranimit; ose
 - b) pezullimi nga OST-ja përkatëse të livrimit, pranimit ose injorimit prej saj të detyrimeve të Palës Pretenduese lidhur me Programimin sipas Kontratës.
2. **Çlirimi nga Detyrimet e Livrimit dhe Pranimit:** Nëse një Palë pengohet plotësisht ose pjesërisht për shkak të Forcës Madhore, në kryerjen e detyrimeve të saj për livrim dhe pranim sipas një ose më shumë Kontratave dhe kjo Palë respekton kërkesat e pikës **8.3 (Njoftimi dhe Lehtësimi i Forcës Madhore)**, do të konsiderohet se nuk ka ndodhur asnjë shkelje ose mospagim nga ana e Palës Pretenduese dhe ajo do të çlirohet (dhe jo thjesht pezullohet) nga këto detyrime për atë periudhë kohore dhe në atë shkallë që kjo Forcë Madhore e pengon performancën e saj. Asnjë detyrim për të paguar dëmet sipas pikës **8 (Zhdëmtimet për Paaftësinë për Livrim dhe Pranim)** nuk do t'i merret Palës Pretenduese lidhur me sasisë të palivruara ose të pamarra.
3. **Njoftimi dhe Lehtësimi i Forcës Madhore:** Pala Pretenduese, sa më shpejt që të jetë e mundur pasi mëson për Forcën Madhore, do të njoftojë Palën tjetër për fillimin e Forcës Madhore dhe, për aq sa është e mundur, do t'i sigurojë një vlerësim jo-detyrues mbi zgjatjen dhe kohëzgjatjen e pritshme të paaftësisë së saj performuese. Pala Pretenduese do të përdorë gjithë përpjekjet komercialisht të arsyeshme për të lehtësuar efektet e Forcës Madhore dhe gjatë vazhdimin të Forcës Madhore, do t'i sigurojë Palës tjetër përditësime të arsyeshme, kur dhe nëse disponohen, mbi zgjatjen dhe kohëzgjatjen e pritshme të paaftësisë performuese.
4. **Efektet e Forcës Madhore mbi Palën Tjetër:** Në rast dhe në atë shkallë që Shitësi çlirohet nga detyrimet e livrimit për shkak të Forcës Madhore, Blerësi do të çlirohet gjithashtu nga detyrimet korresponduese të pranimit dhe pagesës. Në rast dhe në atë shkallë që Blerësi çlirohet nga detyrimet e

pranimit për shkak të Forcës Madhore, Shitësi do të çlirohet gjithashtu nga detyrimet korresponduese të livrimit.

NENI 9 ZHDËMTIMET /KOMPENSIMET

1. **RASTI I MOSPERFORMANCËS NGA ANA E SHITËSIT:** Në atë shkallë që Shitësi (“Pala Livruese”) nuk i konfirmon Blerësit të gjithë sasinë mujore/javore/ditore të përcaktuar në pikën 1, të nenit 2, të kontratës, por në çdo rast jo më shumë se sasia e nevojshme për furnizimin e klientëve fundorë që përfitojnë nga shërbimi universal i furnizimit dhe kjo paaftësi nuk shfaqësohet nga një ngjarje e forcës madhore, Blerësi (“Pala Pranuese”) ka të drejtën e një kompensimi për sasinë e energjisë elektrike që rezulton si diferencë ndërmjet sasisë së përcaktuar në pikën 1, të nenit 2 dhe asaj të nominuar sipas parashikimeve të neneve 4 dhe 5. Në rast se kjo sasi nuk do të plotësohet, atëherë do të kompensohet sipas nenit 5, të VKM-së nr. 244, datë, 30.3.2016, i ndryshuar.

2. **RASTI I MOSRESPEKTIMIT NGA ANA E BLERËSIT:** Në atë shkallë që programet e nominuara nga Blerësi dhe nga Shitësi për ditën në avancë (ose intraday) sipas parashikimeve të neneve 4 dhe 5, rezultojnë më të vogla se sasia konfirmuara për muajin në avancë, atëherë Shitësi për efekt të llogaritjes së sasisë vjetore të energjisë elektrike në kuadër të detyrimit për shërbim publik, konsiderohet se ka përmbushur detyrimin për periudhën në fjalë në sasinë e konfirmuar për muajin në avancë.

3. Në atë shkallë që programet e dërguara nga Blerësi dhe të konfirmuara nga Shitësi në lidhje me sasinë e energjisë elektrike për muajin përkatës, në përputhje me parashikimet e neneve 4 dhe 5, rezultojnë më të mëdha se sasia e parashikuar në pikën 1, të nenit 2, dhe kjo energji ka shkuar për furnizimin e klientëve fundorë, atëherë Shitësi konsiderohet se ka përmbushur në masën e energjisëelektrike të nominuar për ditën në avancë (ose intraday).

4. **Shuma e pagueshme:** shumat e pagueshme sipas nenit 9 do të faturohen dhe paguhen sipas nenit 14 (Faturimi dhe pagesa).

NENI 10 PEZULLIMI I LIVRIMIT

Përveç të drejtave ose zhdëmtimeve të tjera mundshme nëse "Pala që nuk përmbush detyrimet" nuk paguan ndonjë pagesë të vendosur sipas Kontratës, ose sipas kushteve të garancive nëse do aplikohen nuk arrin ta sigurojë, apo zëvendësojë vlerën e kërkuar sipas Kontratës Pala që përmbush detyrimet do të autorizohet, jo më parë se tre (3) Ditë Pune pas dërgimit të një njoftimi me shkrim Palës që nuk përmbush detyrimet, që të pushojë livrimet e mëtejshme të energjisë elektrike dhe të çlirohet (jo thjesht të pezullohet) nga detyrimet kryesore të livrimit) sipas gjithë Kontratave specifike deri kur Pala që përmbush detyrimet të ketë marrë kolateralin e kërkuar ose pagesën e plotë (përfshirë gjithë interesat e mospagimit dhe shpenzimet e tjera) të gjithë shumave të papaguara që i detyrohen palës që përmbush detyrimet. Pezullimi i livrimeve, apo çlirimeve të detyrimeve të tjera të livrimit, nga Palët mund të bëhet vetëm me miratimin e ERE.

NENI 11 KOHËZGJATJA

1. Kontrata është e vlefshme për periudhën 1 Janar-31 Dhjetor .

NENI 12

KUFIZIMI I PËRGJEGJËSISË FINANCIARE

1. **Përrjashtimi i Përgjegjësisë Financiare:** Subjekt i pikave 13.2 dhe 13.3 dhe përveç kur lidhet me shumet e pagueshme sipas nenit 9 (**Zhdëmtimet**), një Palë dhe punonjësit e saj, zyrtarët, nuk kanë përgjegjësi financiare ndaj Palës tjetër për asnjë humbje, kosto, shpenzim ose dëm ("**Dëmet**"), (përfshirë, pa kufizim, çdo përgjegjësi financiare për shkak të çrregullimeve në furnizimin me energji elektrike sipas një Kontrate specifike) që pëson Pala tjetër sipas Marrëveshjes ose lidhur me të, përveç kur këto Dëme shkaktohen nga neglizhenca e madhe, mospagesa e qëllimshme ose mashtrimi i një Pale ose punonjësve, zyrtarëve, përdorur nga kjo Palë për kryerjen e detyrimeve të saj sipas Kontratës.
2. **Dëmi Pasues dhe Kufizimi i Përgjegjësisë Financiare:** Subjekt i pikës 13.3, përgjegjësia ligjore e një Pale sipas Kontratës ose lidhur me të:
 - (a) nuk përfshin përgjegjësinë financiare për Dëme indirekte dhe/ose pasuese, përfshirë, pa u kufizuar, humbjen e fitimit, klientelës, mundësive për biznes ose kursimeve të parashikuara; dhe
 - (b) kufizohet me një shumë të barabartë me shumet e pagueshme për energjinë elektrike të furnizuar ose që do të furnizohet nga një Palë sipas çdo Kontrate specifike përkatëse me kusht që ky kufizim të mos zbatohet për pagesat sipas pikës 9 (**Zhdëmtimet për Paaftësinë për Livrim dhePranim**).
3. **Mospagesa e Qëllimshme, Mashtrimi dhe të Drejtat Themelore:** Asgjë në Marrëveshje nukvepron për të përjashtuar ose kufizuar përgjegjësinë ligjore të Palës për:
 - (a) mospagesën e qëllimshme,
 - (b) mashtrimin; ose
 - (c) çdo veprim që rrezikon të drejtat ligjore themelore të një Pale ose që shkel detyrimet kontraktuale themelore të një Pale.
4. **Detyra për Lehtësimin e Humbjeve:** Për shmangien e dyshimit, dhe subjekt i Legjislacionit në Fuqi, çdo Palë bie dakord se ka për detyrë të lehtësojë Dëmet dhe premtion që do të përdorë përpjekje komercialisht të arsyeshme për minimizimin e çdo Dëmi që mund të pësojë sipas Kontratës ose lidhur me të.

NENI 13

FATURIMI DHE PAGESA

1. **Fatura;** Shitësi do t'i dorëzojë Blerësit një faturë sipas formatit dhe standardeve që parashikon legjislacioni në fuqi, e cila paraqet sasi të totale të Energjisë Elektrike të livruar nga shitësi te blerësi sipas nominimeve ditore të konfirmuara për Muajin paraardhës. Paraqitja e kësaj fature do të bëhet brenda datës 10 të Muajit pasardhës të livrimit të energjisë elektrike (ose kur kjo datë është pushim zyrtar, ditën pasardhëse të punës).
2. **Pagesa;** Blerësi do t'i kryejë pagesën Shitësit kundrejt vlerës së faturës Mujore të nënshkruar nga Palët. Pagesa do të bëhet brenda 30 ditëve nga dita e njoftimit të faturës nga shitësi, Data e pagesës do të konsiderohet data që nga llogaria e Blerësit preken fondet monetare.

3. **Vonesa në kryerjen e pagesës;** Nëse Blerësi dështon në kryerjen e pagesës brenda afatit të përcaktuar në këtë Kontratë, shpërblimi për dëmet e shkaktuara si rezultat i vonesës, do të jetë sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
4. **Faturimi dhe pagesa e sasive të programuara Kontraktuale:** Faturimi dhe pagesa do të bazohen në Sasitë e programuara/nominuara të kontratës në përputhje me të gjitha rregullat në fuqi për dërgimin e Programeve për muajin përkatës. Kur dhe nëse të dhënat faktike bëhen të disponueshme dhe konfirmojnë se sasitë faktike të energjisë elektrike të livruara dhe marra nga palët ndryshojnë nga ato të përcaktuara në Programet e Derguara faturimi dhe pagesa do të rregullohen për të pasqyruar çdo devijim midis sasive të kontraktuara dhe livrimeve faktike të energjisë elektrike.
5. **Shumat e diskutueshme;** Për çdo pretendim që lidhet me saktësinë e faturës, do të jepet një shpjegim me shkrim nga Shitësi ose Blerësit dhe korrektimet në faturë do të bëhen vetëm brenda muajit të faturuar, në të kundërt do të paguhet shuma e faturuar jo më vonë se data e afatit të pagesës dhe diferencat (shtesat apo pakësimet) nga korrektimet do të reflektohen në muajt pasardhës.

NENI 14 TAKSAT DHE TATIMET

Çdo çeshtje që lidhet me taksat dhe tatimet rregullohet nëpërputhje me legjislacionin respektiv për taksat dhe tatimet në Republikën e Shqipërisë.

NENI 15 TRANSFERIMI

1. **Ndalimi:** Asnjëra Palë nuk do të autorizohet që t'ia transferojë të drejtat dhe detyrimet e veta sipas Kontrates, një pale të tretë pa pëlqimin paraprak me shkrim të Palës tjetër, *i cili nuk do të vonohet, refuzohet ose pengohet në mënyrë të paarsyeshme. Çdo transferim i të drejtave dhe detyrimeve bëhet efektiv pas miratimit nga ERE.*
2. **Transferimi tek Filialet:** Çdo Palë do të autorizohet t'ia transferojë të drejtat dhe detyrimet e veta sipas Kontratës, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Palës tjetër, një Filiali me aftësi paguese të njëjtë ose më të madhe. Ky transferim do të hyjë në fuqi vetëm pas marrjes së njoftimit nga Pala tjetër dhe miratimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE).

NENI 16 PËRFAQËSIMET DHE GARANCITË

1. Për të adresuar riskun e çdo Pale, përsa i përket mundësisë për përmbushjen e detyrimeve të palës tjetër, dhe për të siguruar përmbushjen e të gjithë detyrimeve që rezultojnë nga kjo Kontratë apo kontrata specifike, Palët mund të dakortësojnë, më parë apo në çdo kohë pas hyrjes në fuqi, ose në kohën pas nënshkrimit të kontratave specifike, ekzistencën e mbështetjes me garanci kredie dhe Garantues sipas kushteve, të drejtave dhe detyrimeve të dakortësuara prej tyre.

NENI 17
PERSONAT E KONTAKTIT

1. Të gjitha njoftimet, që dërgohen sipas ose në lidhje me këtë Kontratë, duhet të dërgohen me shkrim në adresën e mëposhtme me email ose faks:

Për Blerësin	Për Shitësin
Administratorët e Kontratës	
Z/Znj. _____ Funksioni _____ Tel : _____ Mail : _____	Z/Znj _____ Tel : _____ Mail : _____
Operatorët/Skeduluesit	
Z/Znj. _____ Funksioni _____ Tel : _____ Mail : _____	Z/Znj _____ Tel : _____ Mail : _____

NENI 18
LEGJISLACIONI NË FUQI DHE ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

- Legjislacioni në Fuqi:** Përveç kur specifikohet ndryshe, kjo Kontratëdo të interpretohet dhe drejtohet nga legjislacioni në fuqi në Republikës se Shqipërisë.
- Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve:** Nëse palët nuk arrijnë ta zgjidhin mosmarrëveshjen me mirëkuptim, çdo mosmarrëveshje që ngrihet lidhur me Kontratën do t'i referohet për zgjidhje EREs.Sa më sipër nuk përjashton të drejtën e palëve për të adresuar nëpërmjet Gjykatës zgjidhjen e çdo mosmarrëveshje të krijuar në interpretim apo kuptim të kësaj kontrate.

NENI 19
TË NDRYSHME

- Regjistrimi i Bisedave Telefonike:** Çdo Palë lejohet të regjistrojë bisedat telefonike të mbajtura lidhur me Kontratën dhe t'i përdorë si provë. Çdo Palë pranon se ka marrë gjithë pëlqimet e

nevojshme të zyrtarëve dhe punonjësve të vet për këto regjistrime, dhe këto ja bashkangjit kësaj kontrate.

2. **Njoftimet dhe Komunikimet:** Përveç kur parashikohet ose vendoset ndryshe nga Palet, gjithë njoftimet, deklaratat e dërguara nga një Palë tjetër duhet të jenë me shkrim (postë të shpejtë ose korrier). Çdo Palë mund ta ndryshojë informacionin e njoftimit me anë të një njoftimi me shkrim palës tjetër. Njoftimet me shkrim, deklaratat dhe faturat do të konsiderohen si të marra dhe efektive:
 - a. nëse shpërndahen dorazi Ditën e Punës, ose Ditën e parë të Punës pas datës së fundit të livrimit;
 - b. nëse dërgohen me postë, Ditën e 2^{të} të Punës pas datës së postimit, ose nëse dërgohen nga një shtet në tjetrin, në Ditën e 5^{të} të Punës pas datës së postimit;
 - c. nëse dërgohen me transmetim faksimile dhe prodhohet një raport i vlefshëm transmetimi që konfirmon marrjen, ditën e transmetimit nëse është transmetuar para orës 17.00 (me orën e marrësit) në Ditën e Punës ose në orën 09.00 (me orën e marrësit) në Ditën e parë të Punës pas transmetimit.
3. **Amendimet:** Çdo amendim ose shtesë në këtë Kontratë do të bëhet vetëm me shkrim dhe do të nënshkruhet nga të dyja Palët, dhe hyn në fuqi vetëm pas miratimit nga ERE.
4. **Pavlefshmëria e Pjesshme:** Nëse, në çdo kohë, ndonjë dispozitë e kësaj Kontrate është ose bëhet e paligjshme, e pavlefshme ose e pazbatueshme, në çdo drejtim, sipas ligjit të çdo juridiksioni përkatës, ligjshmëria, vlefshmëria dhe zbatueshmëria e dispozitave të mbetura të kësaj Kontrate, nuk do të preken ose dëmtohen në ndonjë mënyrë. Në rast se legjislacioni në fuqi sjell ndryshime të dispozitave të kësaj kontrate, deri në miratimin nga ERE të këtyre ndryshimeve, legjislacioni i zbatueshëm do të prevalojë në kuptimin dhe interpretimin e këtyre dispozitave.

NENI 20

MIRATIMI I ERE-S, EFEKTET DHE ZGJIDHJA E PARAKOHSHME

1. Kjo kontratë i shtrin efektet për periudhën 1 Janar-31 Dhjetor.
2. Palët kanë detyrimin të njoftojnë ERE lidhur me nënshkrimin e kësaj kontrate.
3. Kjo kontrate tip mund të ndryshohet vetëm me miratimin e ERE.

NENI 21

Kjo kontratë nënshkruhet në 4 (katër) kopje të barazvlefshme, 2 (dy) për secilën palë.

ADMINISTRATOR

ADMINISTRATOR

Shtojca 1: Programet e livrimit sipas Neneve 4 dhe 5 të kësaj kontrate

Shtojca 2: Sipas Nenit 19, të kesaj kontrate “Pëlqimet e nevojshme të zyrtarëve dhe punonjësve të Palëve për regjistrimet telefonike ”